


- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është Agjenci e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave. Agjencia i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe kryesohet nga Këshilli, i cili përbëhet nga Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror dhe katër Mbikëqyrës Shtetëror.




Agjencia në veçanti:

- Jep këshilla organeve publike dhe private për çështjet e ndërlidhura me mbrojtjen e të dhënave;
- Vendos lidhur me ankesat e subjektit të të dhënave;
- Bën inspektime dhe kontrolle;
- Informon publikun për çështjet dhe zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave; dhe
- Promovon dhe përkrah të drejtat themelore për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Mbrojtja e të dhënave personale është e drejtë fundamentale e garantuar me Kushtetutë (neni 36) dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (03/L-172).



- Mbrojtja e të dhënave personale është pjesë e së drejtës në privatësi, si një nga të drejtat dhe liritë elementare të njeriut. Mbrojtja e të drejtës në privatësi është e garantuar me Konventën Evropiane për të Drejtat të Njeriut.



- 28 janar 1981 është data e nënshkrimit të Konventës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale, 25 vjet më vonë në vitin 2006, kjo datë në mënyrë simbolike është zgjedhur, dita Evropiane e mbrojtjes së të dhënave personale.

Adresa: Lagja Pejton, Rr. "Pashko Vasa", Nr.4 Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data




Agjencia Shtetërore për
Mbrojtjen e të Dhënave
Personale

- Të dhënat personale përpunohen në shumë aspekte të jetës së përditshme – si shembull, hapja e një llogarie bankare, rezervimi online i një bilete udhëtimi, blerja e një SIM karteletj.




• Çka janë të dhënat personale ?

- Çdo informacion që mund të ju identifikoj ju, direkt apo indirekt, si: emri, numri i telefonit, adresa elektronike, vendi dhe data e lindjes, numri i identifikimit, identitetin e tij ose saj fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor, shoqëror etj.




• Cilat janë të drejtat tuaja ?

- Kur të dhënat tuaja personale përpunohen, ju keni të drejtë:
 - Të informoheni që të dhënat tuaja personale përpunohen në gjuhë të pastër dhe të kuptueshme.
 - Të keni qasje në të dhënat tuaja.
 - Të kërkonin nga kontrolluesi që të shtojë, korrigjojë, bllokojë, shkatërrojë, fshijë ose asgjësojë të dhënat personale për të cilat ju vërtetoni se janë jo të plota, jo të sakta ose jo të përditësuara, apo nëse janë grumbulluar ose përpunuar në kundërshtim me ligjin.
 - Të konsultoj pa pagesë regjistrin e sistemeve të dosjeve që mbahet nga Agjencia dhe t'i kopjojë ose t'i transkriptojë detajet.
 - Të keni mbrojtje ligjore nëse vëreni se gjatë përpunimit të të dhënave personale ka shkelje të ligjit.



• Cilat janë obligimet e Kontrolluesit të të dhënave?

- Obligimet e kontrolluesit të të dhënave (çdo person fizik dhe juridik nga sektori publik dhe privat që është përgjegjës për përcaktimin e qëllimit dhe mënyrës së përpunimit, p.sh. administratë publike, Organet e Drejtësisë, Bankat, Policia, Spitalet etj) janë:
 - Të siguroj që të drejtat tuaja janë përmbushur
 - Të siguroj që të dhënat grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta, legjitime, sakta, të përditësuara dhe vetëm për atë kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit
 - Siguria e përpunimit
 - Konfidencialiteti i përpunimit
 - Njoftimi tek autoriteti i mbrojtjes së të dhënave (Agjencia)
 - Të siguroj që transferimi i të dhënave jashtë shtetit të bëhet, nëse këto shtete sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave.



• Çka mund të bëni nëse të drejtat tuaja janë shkelur?

- Ju mund të parashtroni ankesë në Agjenci.
- Ankesa mund të parashtrohet gojarisht, me shkrim, ose me mjete elektronike.
- Agjencia pas shqyrtimit të ankesës suaj, do të ju informoj lidhur me rezultatin dhe veprimet e ndërmarra.